



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 28/1 Prot.

Tiranë, më 28 / 01 / 2021

V E N D I M

Nr. 13, Datë 28 / 01 / 2021

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 02, datë 08.01.2021, të paraqitur nga E.Rr kundër Bashkisë Lezhë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjes politike¹” dhe “përkatësisë në një grup të veçantë²”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga E.Rr, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, ankuesi në mes të tjerash informon se: *“Që nga data 25.01.2014 ka qenë i punësuar pranë Komunës Dajç dhe më vonë në Bashkinë Lezhë në detyra të ndryshme. Në datë 31.10.2019 është njoftuar nga Bashkia Lezhë që në datë 05.11.2019, të paraqitej pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore për të biseduar lidhur me zgjidhjen e marrëdhënieve të punës. Gjatë takimit të zhvilluar, ankuesi ka deklaruar se pranon të punonte edhe si punëtor shërbimi, vetëm që të mos ishte i papunë. Me Urdhërin nr. 155, datë 11.02.2020 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare me E.Rr” Bashkia Lezhë ka urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me E.Rr me detyrë specialist jurist, arsimit dhe kulture në Njësinë Administrative Dajç, për arsye të shkurtimit të vendit të punës. Ankuesi informon se referuar list prezencave të muajit shkurt dhe prill 2020 të Njësisë Administrative Dajç, jo vetëm që nuk ka shkurtim të organikës por përkundrazi ka pasur rekrutime të reja për tre persona në funksionin punëtor shërbimesh. Konkretisht janë punësuar shtetasit V.H, F.M dhe L.P, të cilët janë aktivistë dhe militant të Partisë*

¹ Referuar Kartës së Anëtarësisë datë 14.05.2014 të lëshuar nga Partia Demokratike, E.Rr është anëtar i subjektit politik: Partia Demokratike e Shqipërisë.

² Referuar Vërtetimit datë 11.10.2006 të lëshuar nga Shoqata Antikomuniste e të Përndjekurve Politikë, Dega Lezhë, E.Rr është i përndjekur politik.

Socialiste. Ankuesi deklaron se edhe nëse do të pranonte faktin e ristrukturimit të pozicionin të punës, specialist jurist, Bashkia Lezhë duhet të kishte sistemuar atë si punonjës ekzistues përpara se të punësonte punonjës të rinj të cilët nuk kanë arsimin e kërkuar ose nuk kanë eksperiencën në profilin e kërkuar, sikundër ka ai. Ankuesi pretendon se është diskriminuar nga Bashkia Lezhë në të drejtën e tij për punësim, pasi zgjidhja e kontratës së punës nuk ka ndodhur për shkak të suprimimit të vendit të punës, por për shkak të bindjes politike dhe si i përndjekur politik”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Neni 7 i LMD-së³, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankesë, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

³ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 02, datë 08.01.2021 të E.Rr u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 79, datë 12.01.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga, Bashkia Lezhë për ankesën e bërë nga E.Rr si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
 - Kopje të plotë të emërimit dhe të procedurës së ndërprerjes së marrëdhënieve të punës të E.Rr, kopje të kontratës, përkrahimit dhe librezës së punës.
 - Kopje të vlerësimit të punës për vitin 2018 dhe 2019 dhe të masave disiplinore për punonjës të E.Rr.
 - Shpjegime mbi pretendimet e ankuesit lidhur me procesin e punësimit të punonjësve V.H, F.M dhe L.P, kopje të plotë të procedurës së punësimit të këtyre punonjësve, kopje të kontratës dhe përkrahimit të punës.
 - Kopje të strukturës dhe organikës së vjetër të Bashkisë Lezhë dhe njësive në varësi të saj.
 - Kopje të strukturës dhe organikës së re të Bashkisë Lezhë dhe njësive në varësi të saj.
 - Kopje të studimit/relacionit të bërë mbi ristrukturimin e Bashkisë Lezhë dhe procedurës së ndjekur për ngritjen e Komisionit të vlerësimit të punonjësve apo ndonjë strukture tjetër përgjegjëse të Bashkisë, në kuadër të ristrukturimit të saj për vlerësimin e punonjësve.
 - Informacion se sa punonjës të tjerë, specialist jurist, janë larguar si pasojë e ristrukturimit të institucionit. Kopje të akteve të largimit të tyre nga puna.
 - Informacion se sa punonjës të tjerë me arsimin jurist, janë punësuar pranë Bashkisë Lezhë nga periudha datë 15.02.2020 deri në datë 15.08.2020.
 - Kopje të list-prezencës së punonjësve të Njesisë Administrative Dajç për muajt: shkurt, mars dhe prill 2020.
 - Informacion nëse për shkak të ristrukturimit janë larguar dhe punonjës të tjerë nga detyra. Nëse po, një kopje të procedurës së ndjekur për secilin rast.
 - Informacion nëse nga ana e Bashkisë është vlerësuar mundësia e emërimit të ankuesit në ndonjë pozicion tjetër pune, të përshtatshëm me kualifikimin dhe vjetërsinë e tij në punë.
 - Kopje të Rregullores së Brendëshme të Bashkisë Lezhë.
 - Informacion nëse kjo çështje është ndjekur gjyqësisht. Nëse po, kopje të kërkesë padisë dhe vendimit të gjykatës.

- Me shkresën nr. 77, datë 12.01.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar nga ankuesi informacion të mëtejshëm lidhur me çështjet si më poshtë:
 - Shpjegime më të hollësishme në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të bindjeve politike, duke dhënë informacion, fakte apo prova se përse mendoni se punëdhënësi ka patur dijeni për bindjet tuaja politike.
 - A i keni ekspozuar publikisht, në çfarë do lloj mënyre apo mjete, bindjet tuaja politike.
 - Fakte dhe prova që vërtetojnë deklarin tuaj se shtetasit: V.H, F.M dhe L.P, janë aktivistë dhe militant të Partisë Socialiste.
 - Informacion nëse keni aplikuar për tu punësuar si punonjës shërbimi pranë Njesisë Administrative Dajç apo në pozicione të tjera si jurist pranë Bashkisë Lezhë.
 - Çfarë masash kërkon të ndërmerren nga Komisioneri.
 - Informacion nëse kjo çështje po ndiqet gjyqësisht. Nëse po, një kopje të kërkesë padisë dhe vendimit të gjykatës, nëse ka.

Me shkresën datë 19.01.2021, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 77/1, datë 20.01.2021, ankuesi vuri në dispozicion të Komisionerit, prova dhe fakte shtesë, kopje të kërkesë padisë për largimin e tij nga puna drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, si dhe në mes të tjerash informoi se: *“Bashkia Lezhë ka pasur dijeni për bindjet e tija politike për faktin se në mjedisin e punës dhe në qytetin e vogël të Lezhës, familja e tij njihet si familje të përndjekurish politikë si dhe ka marrë pjesë në fushatat dhe takimet elektorale të Partisë Demokratike, por që bindjet e tija politike nuk kanë ndikuar në motivimin dhe përkushtimin e tij në punë. Ankuesi informon se gjatë takimit të zhvilluar me punëdhënësin në datë 05.11.2019, ka deklaruar se pranon të punonjë dhe si punëtor shërbimi, por nuk ka aplikuar për tu punësuar si punëtor shërbimi. Ankuesi kërkon nga Komisioneri rikthimin në vendin e punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të”*.

Bazuar në kërkesë padinë e ankuesit, paraqitur kundër institucionit të Bashkisë Lezhë, Komisioneri u vu në dijeni të faktit se, në objekt të saj, ankuesi ka kërkuar ndër të tjera dhe: *“Konstatimin e diskriminimit të paditësit E.Rr, në të drejtën për punësim, për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë dhe bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Lezhë”*. Pra, pretendimin për diskriminim për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë dhe bindjes politike, ankuesi i ka bërë objekt shqyrtimi gjyqësor.

Po ashtu, në citim të bazës ligjore, ankuesi i referohet, ndër të tjera dhe Ligjit nr.10221, datë 04.02.2012 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.

Theksojmë se të njëjtat fakte dhe rrethana që janë paraqitur përpara Komisionerit, bëhen prezent dhe në kërkesë padinë e paraqitur para Gjykatës, ku ankuesi ka pretenduar ndër të tjera se: *“Ndihet i diskriminuar nga Bashkia Lezhë, pasi është pushuar nga puna vetëm për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë dhe bindjes politike dhe se nuk ka shkak tjetër për pushimin nga puna si, paaftësi në punë, arsimi apo moskryerje të detyrave të ngarkuara”*.

Juridiksioni gjyqësor është i ndarë nga ai administrativ, por aktet e këtij të fundit janë objekt kontrolli nga gjykata administrative, e cila vendos përfundimisht për çështjen.

Përsa më sipër, pavarësisht dokumentimit të përkatësisë në një grup të veçantë dhe bindjeve politike të ankuesit, në kushtet kur kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjkata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, si dhe në mbështetje të pikës 7/4, të nenit 33, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatimin e diskriminimit, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për pushimin e çështjes”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë dhe bindjeve politike.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), nenit 33, pikat 1, 3, 5, 7 dhe 10, si dhe pikës 7/4 të nenit 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën e hetimit të ankesës Nr. 02, datë 08.01.2021, të shtetasit E.Rr, pasi çështja e parashtruar në ankesën e mësipërme, me të njëjtat palë dhe të njëjtin objekt, është duke u gjykuar nga Gjkata e Rrethit Gjyqësor Lezhë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

Robert GAJDA

KOMISIONER